



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

Nr. 11452 prot.,

Vlorë, më 18.07.2024

PROJEKT- VENDIM

Nr. _____ datë _____ 2024

PËR TRAJTIMIN ME PAGESAT E QIRASË SIPAS PROGRAMEVE PËR STREHIMIN SOCIAL TË ZNJ. RUKIJE SHABANI, PËR SHKAK SE BANESA E SAJ PREKET NGA ZBATIMI I PROJEKTIT “LIDHJA E RRUGËS TRANSBALLKANIKE ME PORTIN DETAR VLORË”.

Këshilli i Bashkisë Vlorë, në mbështetje të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 1 dhe 2, neni 24 pika 1, të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për strehimin social” të ndryshuar, neni 67/b, neni 73/2,c, të VKM Nr.361 datë 29.05.2019 “Për përcaktimin e procedurave të zhvendosjes së individëve/familjeve nga vendbanimi a strehimi i tyre, në rastet e parashikuara në ligj, dhe të bashkëpunimit institucional”, të VKM Nr.384 datë 12/06/2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, të VKM Nr.301, datë 15.04.2020 “Për normat e strehimit, si edhe kushtet e standartet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët”, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Drejtoria e infrastrukturës dhe Investimeve Publike dhe Vendimin Komisionit të Strehimit të Bashkisë Vlorë;

V E N D O S I

- I. Të miratojë trajtimin me pagesat e qirasë sipas programeve për strehimin social të znj. Rukije Shabani, për shkak se banesa e saj preket nga zbatimi i projektit “Lidhja e rrugës Transballkanike me Portin Detar Vlorë”.
- II. Trajtimi me pagesat e qirasë sipas programeve për strehimin social do të jetë për një periudhë 3-vjeçare, duke filluar nga data e daljes nga banesa e në vijim.
- III. Masa e qirasë mujore që do të përfitojë kjo shtetase të jetë sipas vlerës së qirasë mesatare të miratuar për strukturën e apartamentit që i takon me normat e strehimit, aktualisht prej 10000 lekë në muaj.
- IV. Efektet financiare sipas pikës 3 do të mbulohen nga buxheti i Bashkisë Vlorë për vitin 2024.
- V. Efektet financiare për dy vitet e tjera të mbulimit të qirasë do të planifikohen në buxhetet përkatëse të Bashkisë Vlorë.
- VI. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Infrastrukturës & Investimeve Publike, Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit pranë Bashkisë Vlorë.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 date 17.12.2015, neni 55, pika 6.

KRYETAR
Ermal Dredha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

RELACION
Për projekt-vendimin

PËR TRAJTIMIN ME PAGESAT E QIRASË SIPAS PROGRAMEVE PËR STREHIMIN SOCIAL TË ZNJ. RUKIJE SHABANI, PËR SHKAK SE BANESA E SAJ PREKET NGA ZBATIMI I PROJEKTIT “LIDHJA E RRUGËS TRANSBALLKANIKE ME PORTIN DETAR VLORE”.

Objekt i këtij projekt-vendimi është rasti i znj. Rukije Shabani, e cila ka poseduar objekt banimi dy katësh në lagjen “1Maji”, rruga “Irakli Pylli”, që ndodhet branda gjurmës së projektit “Lidhja e rrugës Transballkanike me Portin Detar Vlorë”

I konsideruar si ndërtim pa leje me funksion banimi, i vetëdeklaruar pranë ALUIZN-it, objekti është skualifikuar nga vendimet për legalizim të Drejtorisë Vendore të ASHK-së Vlorë dhe nga “Leja infrastrukturore nr.545, datë 25.09.2020” e Bashkisë Vlorë.

Në zbatim të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për strehimin social” të ndryshuar, dhe të VKM Nr.361 datë 29.05.2019 “Për përcaktimin e procedurave të zhvendosjes së individëve/familjeve nga vendbanimi a strehimi i tyre, në rastet e parashikuara në ligj, dhe të bashkëpunimit institucional”, *individ/familja, ndaj të cilit fillon procesi administrativ i zhvendosjes nuk duhet të mbetet i pastrehë. Njësia e vetëqeverisjes vendore garanton dhe ofron një strehim të përshtatshëm alternativ.*

Për shkak se kjo familje kanë pranuar të jetojë në banesë me qira të marrë në tregun e lire dhe me shkresën Nr. 10480Prot., datë 02.07.2024 ka aplikuar pranë Bashkisë Vlorë për të përfituar subvencion qiraje, Bashkia Vlorë merr përsipër të mbulojë pagesën e qirasë për këtë familje për një periudhë 3-vjeçare, duke filluar nga data e daljes nga banesa. Kjo do të bëhet, duke marrë parasysh procedurat e ndjekura në projekte të ngjashme të financuara, apo të bashkëfinancuara me pushtetin qëndror.

Përcaktimi i pagesës së qirasë që përfiton kjo familje bazohet në:

1. Ligjin nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për strehimin social”, të ndryshuar
2. VKM Nr.361, datë 29.05.2019 Për përcaktimin e procedurave të zhvendosjes së individëve/familjeve nga vendbanimi a strehimi i tyre, në rastet e parashikuara në ligj, dhe të bashkëpunimit institucional”.
3. VKM Nr.384 datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”
4. VKM Nr.301, datë 15.04.2020 “Për normat e strehimit, si edhe kushtet e standartet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët”, të ndryshuar.
5. VKB Vlorë Nr.75, datë 30.09.2022 “Për miratimin e vlerave mesatare të qirasë së tregut të lirë”

Duke qenë një person në çertifikatën e gjendjes familjare aktuale znj. Rukije Shabani do të trajtohet me pagesën 10000 lekë/muaj për një periudhë 3 vjeçare, duke filluar nga data e daljes nga banesa e në vijim.

KRYETAR
Ermal Dredha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KOMISIONI I STREHIMIT

Nr. 11452 prot.,

Vlorë, më 18.07 .2024

MIRATOHET
KRYETAR

Ermal Dredha

VENDIM

Nr.5 , datë 15.07.2024

PËR TRAJTIMIN ME PAGESAT E QIRASË SIPAS PROGRAMEVE PËR STREHIMIN SOCIAL TË ZNJ. RUKIJE SHABANI, PËR SHKAK SE BANESA E SAJ PREKET NGA ZBATIMI I PROJEKTIT “LIDHJA E RRUGËS TRANSBALLKANIKE ME PORTIN DETAR VLORE”.

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 1 dhe 2, neni 24 pika 1, të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për strehimin social” të ndryshuar, neni 67/b, neni 73/2,c, të VKM Nr.361 datë 29.05.2019 “Për përcaktimin e procedurave të zhvendosjes së individëve/familjeve nga vendbanimi a strehimi i tyre, në rastet e parashikuara në ligj, dhe të bashkëpunimit institucional”, të VKM Nr.384 datë 12/06/2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutuar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, të VKM Nr.301, datë 15.04.2020 “Për normat e strehimit, si edhe kushtet e standartet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët”, Komisioni i Strehimit të Bashkisë Vlorë i mbledhur sot në datën 15.07.2024, pasi shqyrtoi rastin e znj. Rukije Shabani,

KONSTATOI SE:

Znj. Rukije Shabani ka poseduar object banimi dy katësh në lagjen “1Maji”, rruga “Irakli Pylli”, që ndodhet branda gjurmës së projektit “Lidhja e rrugës Transballkanike me Portin Detar Vlorë”

I konsideruar si ndërtime pa leje me funksion banimi, i vetëdeklaruar pranë ALUIZN-it, objekti është skualifikuar nga vendimet për legalizim të Drejtorisë Vendore të ASHK-së Vlorë dhe nga “Leja infrastrukturore nr.545, datë 25.09.2020” e Bashkisë Vlorë.

Ndodhur në këto kushte kjo familje ka pranuar të jetojë në banesë me qira të marrë në tregun e lirë.

Referuar ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për strehimin social” të ndryshuar, dhe të VKM Nr.361 datë 29.05.2019 “Për përcaktimin e procedurave të zhvendosjes së individëve/familjeve nga vendbanimi a strehimi i tyre, në rastet e parashikuara në ligj, dhe të bashkëpunimit institucional”,



individuale familje, ndaj të cilit fillon procesi administrativ i zhvendosjes nuk duhet të mbetet i pastrehë. Njësia e vetëqeverisjes vendore garanton dhe ofron një strehim të përshtatshëm alternativ.

Sa më lart komisioni

VENDOSI

1. Duke marrë parasysh procedurat e ndjekura në projekte të ngjashme të financuara, apo të bashkëfinancuara me pushtetin qendror, Bashkia Vlorë të mbulojë pagesën e qirasë për këtë familje për një periudhë 3-vjeçare, duke filluar nga data e daljes nga banesa.
2. Masa e qirasë mujore që do të trajtohet kjo shtetase të jetë sa qiraja mesatare në treg të lirë e miratuar me VKB Vlorë Nr.75, datë 30.09.2022, sipas strukturës që përfiton me normat e strehimit, aktualisht 10000 lekë.
3. Mbi këtë vendim të përgatitet project-vendimi për tu paraqitur për miratim në Këshillin e Bashkisë Vlorë

KOMISIONI :

1. Irena Toshkallari
2. Zambak Selmani
3. Dorian Demiri
4. Skerdilajd Hunda
5. Orest Ruçaj
6. Manuela Prifti
7. Donald Leskaj

8. Bledar Toja
9. Kanan Shakaj
10. Genard Fegaj
11. Selim Haskoçelaj
12. Birçe Aliraj
13. Drita Mustafai